



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr.960/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, Gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në çështjen juridike të paditësit “Auto Sherreti” Shpk, me NUI:810659039, me seli në Prishtinë e përfaqësuar nga A.F. dhe L.R., kundër të paditurës Dogana Kosovës me seli në Prishtinë, me kërkesë për anulimin të konfiskimit të sigurisë së tenderit me numër serik 070010210013114 të lëshuar nga Kompania e Sigurimeve “Pristig”, jashtë seancës me datën 26.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Departamenti për Çështje Administrative, Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale të Kosovës, shpallet JO KOMPETENT, për të vendosur sipas padisë “Auto Sherreti” Shpk, me NUI:810659039, me seli në Prishtinë, me kërkesë për anulimin të konfiskimit të sigurisë së tenderit me numër serik 070010210013114 të lëshuar nga Kompania e Sigurimeve “Pristig”, lidhur me kontratën 201 133000-19-4136-1-1-1 të lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës Dogana e Kosovës.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi dosja e lëndës më të gjitha shkresat e saj i dërgohet Departamentit Ekonomik të Gjykatës Komerciale.

A r s y e t i m

Me datë 23.06.2021 padisë “Auto Sherreti” Shpk, me NUI:810659039, me seli në Prishtinë, me kërkesë për anulimin të konfiskimit të sigurisë së tenderit me numër serik 070010210013114 të lëshuar nga Kompania e Sigurimeve “Pristig”, lidhur me kontratën 201 133000-19-4136-1-1-1 të lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës Dogana e Kosovës.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë Gjykata vlerëson së konfiskimit i sigurisë së tenderit me numër serik 070010210013114 të lëshuar nga Kompania e Sigurimeve “Pristig”, lidhur me kontratën 201 133000-19-4136-1-1-1 të lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës Dogana e Kosovës, nuk konsiderohet vendim përfundimtar ndaj të cilit mund të fillohet procedura administrative në kuptim të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, Neni 13, ku përcaktohet se Konflikti administrativ: 1. *Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë dhe 2. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar*, dhe në kuptim të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Neni 44, ku përcaktohet kuptimi i Aktit administrativ: 1. *Akti administrativ është çdo manifestim vullneti i një organi publik, që rregullon në mënyrë të njëanshme një marrëdhënie juridike konkrete të së drejtës administrative, me qëllim prodhimin e pasojave juridike*.

Sepse, konfiskimit i sigurisë së tenderit me numër serik 070010210013114 të lëshuar nga Kompania e Sigurimeve “Pristig”, lidhur me kontratën 201 133000-19-4136-1-1-1 të lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës Dogana e Kosovës, nuk është akt administrativ i njëanshëm dhe as përfundimtar në një procedurë administrative, ngase buron nga një marrëveshje e palëve në këtë rast kontratës në mes të paditësit dhe të paditurës në të cilën është shprehur vullneti i dyanshëm i palëve që përmes kontraktimit të garancisë së ofertës që të bëhet sigurimi i kushteve të tenderit, më çka me urdhër të tenderuesit në këtë rast paditësit- marrësi i Garancisë Kompania e Sigurimeve “Pristig”, ka marrë përgjegjësinë ndaj të paditurës në kuptim të nenit 1083 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 29/78, 39/85, 57/89), Kreu XXXVIII, nenet 1083 deri 1087; të cilat përshtatshmërisht vazhdojnë të aplikohen, sipas nenit Neni 1058 të Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, që në rast të plotësimit të kushteve të cekura në Garanci të paguaj shumën e siguruar.

Prandaj, gjykata vlerëson se në këtë rast kemi të bëjmë me një kontest që buron nga një marrëdhënie kontraktuale detyrimore, për të cilën është kompetent Departamenti për Çështje Ekonomike i kësaj gjykate, sipas Ligjit (NR. 08/L-015) për Gjykatën Komerciale, Neni 13 ku përcaktohet kompetenca e Gjykatës Komerciale me juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë, si dhe kompetenca e secilit departament

në Dhomat e Shkallës së Parë. Sipas paragrafit 2 të njejtit Nen, *të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.9 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Ekonomike, e që në nën-paragrafin 1.1 hyjnë kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre.*

Ndërsa, në Departamentin për çështje administrative, në shkallë të parë sipas paragrafit 5, të njejtit Nen hyjnë *kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative të përcaktuara në nën-paragrafin 1.12 të njejtit Nen.*

Prandaj, çështja juridike paditësit Auto Sherreti” Shpk, me NUI:810659039, me seli në Prishtinë, me kërkesë për anulimin të konfiskimit të sigurisë së tenderit me numër serik 070010210013114 të lëshuar nga Kompania e Sigurimeve “Pristig”, lidhur me kontratën 201 133000-19-4136-1-1-1 të lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës Dogana e Kosovës, i dërgohet për shqyrtim në Departamentin përkatës të njëjtës gjykatë.

Për arsyet e cekura më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenin 17 lidhur me nenin 387.1 pika (u) dhe nenin 392 pika. (b) të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe nenit 13 të Ligjit për Gjykatën Komerciale.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.960/24, datë 26.04.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

---

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta e ankesës, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate